



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Arsimit dhe Shkencës
Ministarstvo Obrazovanja i Nauke/ Ministry of Education and Science

Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister



Numër: 01-3470
Data: 17.07.2026

Ministri i Arsimit dhe Shkencës, në mbështetje të neneve 8, 10 dhe 11 të Ligjit nr. 06 / L-113 për Organizimin dhe Funksimimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta zyrtare nr. 7/01 mars 2019), nënparagrafit 1.5 i paragrafit 1 të nenit 11 të Ligjit nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës (G. z. e Republikës së Kosovës/nr. 34/18 nëntor 2022, Prishtinë), të nenit 50 paragrafit 1 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës/ nr.20/21 qershor 2016, Prishtinë), Udhëzimit administrativ të MASH nr. 20/2023 për krijimin e skemave për mbështetje financiare të studentëve për ndarjen e bursave dhe vendimit të Ministrit, nr. 01-263, datë: 04.06.2026, nxjerr:

V E N D I M

Për korrigjim të Vendimit nr. 01/3175, dt. 13.07.2026

1. Korrigjohet vendimi me nr. 01/3175, i datës 13.07.2026 për përfitueset vajza/gra të regjistruara për herë të parë në vitin akademik 2025/2026 në programet e fushave të Shkencës, Teknologjisë, Inxhinierisë dhe Matematikës (STEM), duke i hequr pikës 1 të Vendimit të korrigjuar përfituesen me numrin rendor 516.
2. Pjesët tjera të Vendimit nr. 01/3175, dt. 13.07.2026, mbesin të pandryshuara.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Duke u bazuar në dispozitat e cekura më lart, kërkesën e DALSH në MASH me nr. 5-1308 i dt. 15.07.2026, si dhe pas rishqyrtimit të listës së aplikimit së të gjitha studenteve përfituese të IAL-ve nga Komisioni Vlerësues, është konstatuar se përfituesja me numër rendor 516, e thirrjes për mbështetje financiare të studenteve përfituese vajza/gra të regjistruara për herë të parë në vitin akademik 2025/2026, në fushat e Shkencës, Teknologjisë, Inxhinierisë dhe Matematikës (STEM), nuk i përket nivelit të studimeve për çfarë thirrja ka qenë e destinuar. Përfshirja e saj në listën e përfitueseve ka qenë rezultat i një gabim të paqëllimshëm administrativ gjatë procesit të vlerësimit nga Komisioni Vlerësues, si pasojë e numrit të madh të aplikimeve të shqyrtuara.

Me rastin e rishqyrtimit të listës, Komisioni Vlerësues e ka identifikuar këtë gabim dhe, për rrjedhojë, ka propozuar korrigjimin e tij, ashtu siç përcaktohet në dispozitivin e këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

1. Palës së lartpërmendur;
2. Anëtarëve të Komisionit vlerësues;
3. Kabinetit të Ministrit;
4. DALSH/MASH;
5. Zyrës së Sekretares së përgjithshme/MASH;
6. Arkivit/MASH.

Hajrulla Çeku

Ministër në detyrë/MASH

